

STATISTIKAT E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT NË NDËRMARRJE

2026

Për herë të parë, rezultatet e vërtetimit mbi "Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK)" pranë ndërmarrjeve ekonomike me 10 e më shumë të punësuar publikohen sipas **Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev. 2.1. Ky ndryshim në klasifikimin e veprimtarive ekonomike zbatohet për vitin referencë 2026, në përputhje me Rregulloren Zbatuese (BE) 2025/1322. Për të siguruar krahasueshmërinë e të dhënave me një vit më parë dhe analizën e saktë të ndryshimeve në kohë, edhe të dhënat për vitin 2025 janë riklasifikuar sipas NVE Rev. 2.1. Për rrjedhojë, të dyja seritë e të dhënave, për vitet 2025 dhe 2026, paraqiten sipas së njëjtës nomenklaturë.*

- Përdorimi i internetit: Në vitin 2026, 99,5 % e ndërmarrjeve kanë përdorur kompjuter me akses në internet për qëllime pune, nga 99,4 % që ishte në vitin 2025.
- Punonjësit: Në vitin 2026, 38,3 % e të punësuarve përdorin kompjuter me akses në internet për qëllime pune nga 35,1 % që ishte në vitin 2025.
- Shpejtësia e internetit: Në vitin 2026, 66,6 %, e ndërmarrjeve përdorin internet me shpejtësi shkarkimi mbi 100 Mbit/s nga 50,4 % që ishte në vitin 2025.
- Website: Në vitin 2026, 62,9 % e ndërmarrjeve kanë një faqe interneti nga 61,0 % që ishte në vitin 2025.
- Mediat sociale: Në vitin 2026, përdorimi i mediave sociale u rrit në 88,1 %, me një rritje 1,6 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2025.
- Shitjet online: Në vitin 2026, 31,3 % e ndërmarrjeve kanë shitur produkte ose shërbime nëpërmjet faqes së internetit, aplikacioneve të dedikuara, faqeve e-commerce dhe platformave të tjera digjitale, nga 28,1 % që ishte në vitin 2025.
- Xhiro totale: Në vitin 2026, xhiroja e realizuar nga shitjet online arriti në 11,4 %, me një rritje prej 1,3 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2025.
- Specialistët TIK: Në vitin 2026, 34,5 % e ndërmarrjeve punësojnë specialistë të TIK-ut, nga 31,8 % në vitin 2025.
- Shërbimet cloud: Në vitin 2026, 35,3 % e ndërmarrjeve përdorën shërbime cloud, nga 33,9 % në vitin 2025.

- Planifikimi i burimeve të ndërmarrjes: Në vitin 2026, 36,9 % e ndërmarrjeve përdorën një ose një grup aplikacionesh softuerike (ERP) nga 31,1 % që ishte në vitin 2025.
- Inteligjenca artificiale: Në vitin 2026, 12,4 % e ndërmarrjeve përdorën sisteme të inteligjencës artificiale, nga 9,0 % që ishte në vitin 2025.


Sipas madhësisë së ndërmarrjeve:

- Website: të gjitha ndërmarrjet e mëdha (me mbi 250 të punësuar) zotërojnë një faqe interneti. Ky nivel prej 100 % është arritur që në vitin 2025 dhe mbetet i qëndrueshëm. Ndërmarrjet e mesme me 50-249 të punësuar u rritën nga 62,8 % në vitin 2025 në 64,7 % në vitin 2026.
- Media sociale: shënoi rritjen më të madhe në ndërmarrjet e vogla me 10-49 të punësuar, nga 85,5 % në vitin 2025 në 87,5 % në vitin 2026.
- Shitjet online: rritjen më të madhe e shënuan ndërmarrjet e mesme me 50-249 të punësuar, nga 14,2 % në vitin 2025 në 22,9 % në vitin 2026.
- Inteligjenca artificiale: rritjen më të madhe e shënoi në ndërmarrjet me 250+ të punësuar, nga 24,8 % në vitin 2025 në 28,1 % në vitin 2026.
- Shërbimet cloud: Në vitin 2026, përdorimi i shërbimeve cloud u rrit në të gjitha grupet e ndërmarrjeve sipas madhësisë. Tek ndërmarrjet e mëdha me 250+ të punësuar, përqindja u rrit nga 54,5 % në vitin 2025 në 59,2 % në vitin 2026. Tek ndërmarrjet e mesme, ajo u rrit nga 46,3 % në vitin 2025 në 49,7 % në vitin 2026, ndërsa tek ndërmarrjet e vogla nga 31,0 % në vitin 2025 në 32,0 % në vitin 2026.

Sipas aktivitetit ekonomik:


- Shitjet online: sektorët që regjistruan peshën më të madhe në shitjen e produkteve dhe shërbimeve online për vitin 2026:
 - Aktivitetet e shërbimeve të telekomunikacionit, programimit kompjuterik, konsulencës, infrastrukturës kompjuterike dhe shërbimeve të tjera të informacionit: 53,8 %.
 - Akomodimi dhe shërbimi ushqimor: 52,7 %.
- Specialistët TIK: sektorët me përqindjen më të lartë të punësimit të specialistëve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit janë për vitin 2026:
 - Aktivitetet e botimit, transmetimit, prodhimit dhe shpërndarjes së përmbajtjeve: 79,3 %.
 - Aktivitetet e shërbimeve të telekomunikacionit, programimit kompjuterik dhe shërbimeve të tjera të informacionit: 73,8 %.

FIG. 1 PËRDORIMI I INTERNETIT NË NDËRMARRJE SIPAS MADHËSISË SË NDËRMARRJES, 2025 - 2026



Burimi: Anketa e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në ndërmarrje

FIG. 2 NDËRMARRJET QË SHESIN PRODUKTE/SHËRBIME ONLINE NËPËRMJET FAQEVE TË INTERNETIT, SIPAS MADHËSISË SË NDËRMARRJEVE NË % , 2025-2026




Burimi: Anketa e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në ndërmarrje

TAB. 1 VLERA E XHIROS SË REALIZUAR NGA SHITJET ONLINE NË %, SIPAS MADHËSISË SË NDËRMARRJES, NDAJ SHITJEVE TË REALIZUARA GJATË VITIT 2025 - 2026.

	2025	2026
<u>Gjithsej</u>	10,1	11,4
250+ të punësuar	9,9	12,1
50-249 të punësuar	10,1	10,1
10-49 të punësuar	11,9	12,1

Burimi: Anketa e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në ndërmarrje

FIG. 3 NDËRMARRJET QË SHESIN PRODUKTE/SHËRBIME ON-LINE NËPËRMJET FAQEVE TË INTERNETIT/APLIKACIONEVE KUNDREJT NUMRIT TOTAL TË NDËRMARRJEVE, SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK(%), 2026



Burimi: Anketa e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në ndërmarrje

Shënim për përdoruesit:

- Të dhënat e detajuara janë të disponueshme në databazën statistikore të INSTAT: [TIK në ndërmarrje](#)
- Në zbatim të Politikës së Trajtimit të Gabimeve, INSTAT ndërmerr pa vonesë korrigjimin e çdo gabimi të identifikuar në statistikat zyrtare të publikuara. Përdoruesit informohen në mënyrë të menjëhershme dhe transparente për korrigjimet dhe ndryshimet e reflektuara, në përputhje me parimet e paanshmërisë, transparencës dhe cilësisë së statistikave zyrtare. Politika e plotë e Trajtimit të Gabimeve është e disponueshme në adresën: <https://www.instat.gov.al/media/9577/politika-e-trajtitimit-te-gabimeve.pdf>

Metodologjia

Për matjen e nivelit të treguesve të përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit INSTAT ka kryer në vitin 2026 vërtetimin mbi “Për përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit” pranë ndërmarrjeve ekonomike me 10 e më shumë të punësuar.

Qëllimi i vërtetimit “Për Përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit” është të mbledhë dhe shpërndajë informacion të harmonizuar dhe të krahasueshëm për përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në ndërmarrje. Për matjen e përdorimit të TIK, INSTAT ka intervistuar 2.384 ndërmarrje të të gjitha formave ligjore dhe llojeve të pronësisë me 10 e më shumë të punësuar.

Në përputhje me Rregulloren Zbatuese (BE) 2025/1322 për vërtetimin me vit referencë 2026 njësitë statistikore të vërtetimit janë ndërmarrjet me 10 ose më shumë të punësuar që rezultojnë aktive nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve të klasifikuara si më poshtë:

Madhësisë së ndërmarrjes:

- 10–49 të punësuar
- 50–249 të punësuar
- 250 e më shumë të punësuar

Vërtetimi përfshiu ndërmarrjet e klasifikuara sipas nomenklaturës së veprimtarive ekonomike. Për vitin referencë 2026, u aplikua për herë të parë standardi NVE Rev.2.1 në nivel seksioni, duke respektuar rregulloren evropiane dhe aktet përkatëse zbatuese.

Përkufizime:

Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) i referohet teknologjive që sigurojnë akses në informacione përmes telekomunikimit. Termi TIK është i ngjashëm me termin Teknologji Informacioni (TI), por fokusohet në teknologjitë e komunikimit që përfshijnë internetin, rrjetin, celularët dhe media të tjera komunikimi.

Akses në Internet: Termi “Akses në Internet” i referohet një lidhjeje të jashtme në Internet përmes një kompanie që operon si Ofrues i Shërbimit në Internet (Internet Service Provider – ISP).

Website: Faqja e internetit është një dokument me HyperText. Ekzistenca e një website i ofron ndërmarrjes potencial për një performancë më të mirë, mundësi të reja për prezantimin e ndërmarrjes, produkteve, mundësi për njohje më të madhe dhe në të njëjtën kohë aksesin në tregje të reja dhe për rrjedhojë të ardhura më të larta. Faqet e internetit mund të kenë tekst, lidhjet HyperText, imazhe, video dhe zëra.

Media Sociale: Përdorimi i Mediave Sociale si p.sh.: Facebook, Google+, Twitter, YouTube etj. i referohet përdorimit nga ndërmarrja të aplikacioneve që bazohen në teknologjinë e Internetit ose në platforma

komunikimi për t'u lidhur, krijuar dhe shkëmbyer përmbajtje online, me klientë, furnizues, dhe partnerë, jashtë ose brenda ndërmarrjes.

Shitjet Online: Janë shitjet e bëra nëpërmjet një dyqani në internet (web shop), nëpërmjet formularëve në web në një faqe interneti ose ekstranet, ose aplikacione pavarësisht se si aksesohet në web (kompjuter, laptop, telefon celular etj.). Pagesa mund të bëhet online ose offline (paguaj në dorëzim të porosisë). Deri në vitin 2022 në këtë tregues janë përlogaritur shitjet ku pagesa është kryer vetëm online.

Specialistë TIK: Konsiderohen ata punonjës të cilët si detyrë kryesore kanë të zhvillojnë, operojnë apo të mirëmbajnë sisteme dhe aplikacione TIK, të tillë si: specialistë të bazës së të dhënave, specialistë të mbështetjes ndaj TIK-ut, etj. Specialistët TIK kanë aftësitë përkatëse për të specifikuar, projektuar, instaluar, mbështetur, menaxhuar, vlerësuar ose kryer aktivitete kërkimore.

Shërbimet cloud: I referohen shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, që përdoren në internet për të aksesuar programe kompjuterike, kapacitete ruajtëse, etj. Cloud Computing është një model për të mundësuar hyrje të kudo gjendur, të përshtatshme, në bazë të kërkesës, në një grup të përbashkët burimesh kompjuterike të konfigurueshme (p.sh. rrjetet, serverat, hapësira ruajtëse, aplikacionet dhe shërbimet) që mund të sigurohen me shpejtësi dhe të lirohen me përpjekje ose shërbim minimal të menaxhimit ose të ndërveprimit të ofruesit.

Planifikimi i Burimeve të Ndërmarrjes (Enterprise Resource Planning - ERP) përbëhet nga një ose një grup aplikacionesh softuerike që integrojnë informacionin dhe proceset në të gjithë funksionet e ndryshme të biznesit të ndërmarrjes. Zakonisht, një ERP integron planifikimin, prokurimin, shitjet, marketingun, menaxhimin e marrëdhënieve me klientët, financat dhe burimet njerëzore.

Inteligjenca artificiale u referohet sistemeve që përdorin teknologji të tilla si: text mining, vizioni kompjuterik, njohja e të folurit, gjenerimi i gjuhës natyrore, mësimi makineror (machine learning) dhe mësimi i thellë (deep learning) për të mbledhur, përdorur dhe/ose prodhuar të dhëna; për shembull, për të bërë parashikime, rekomandime ose vendime, me shkallë të ndryshme autonomie.

Menaxhimi i Marrëdhënieve me Klientët (Customer Relationship Management - CRM) është një metodologji menaxhimi që e vendos klientin në qendër të veprimtarisë së biznesit, bazuar në përdorimin intensiv të teknologjive të informacionit për të mbledhur, integruar, përpunuar dhe analizuar informacionin që lidhet me klientët.